



UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I HISTORISË DHE FILOLOGJISË
DEPARTAMENTI I ARKEOLOGJISË DHE TRASHËGIMISE KULTURORE

PROGRAMI I LËNDËS
Drejtimi : Arkeologji dhe Trashëgimi Kulturore

**TITULLI I LËNDËS: PARIME TË RESTAURIMIT TË VEPRAVE TË ARTIT
DHE OBJEKTEVE TË TK**

Pedagogu: PhD.c. Edlira Çausi dhe PhD.c. Erinda Ndreçka

Ngarkesa: 6 ECTS (45 leksione dhe 15 seminare)

Lloji i lëndës: disiplinë e formimit të përgjithshëm (bazë)

Programi i studimit: Bachelor

Viti/Semestri: III/II

EKSTRAKT

Ky cikël leksionesh ka për qëllim njohjen e studenteve me konceptin e restaurimit të veprave të artit dhe objekteve të trashëgimisë kulturore materiale. Historia dhe Evoluimi i koncepteve të restaurimit të artefakteve do të pasohet edhe nga disa leksione që kanë në themel teorinë e restaurimit të veprave të trashëgimisë artistike si dhe njohja me kendveshtrimin historik dhe estetik të veprës. Në këtë cikël leksionesh përshkruhen gjithashtu teknikat analitike shkencore. Terminologjia kryesore nënvizon procedurat që duhet të ndiqen për të arritur të dhëna të sakta për procedurat që duhet të ndiqen për restaurimin e objekteve të TK. Një leksion do të përmbledhe edhe rrymat e ndryshme dhe evoluimin e konceptit të restaurimit arkitektonik në Europë. Nuk do të mungojnë edhe njohja me kartat e restaurimit, si dokument themelor bazë, zbatimin e parimeve të restaurimit.

Në këtë cikël leksionesh përshkruhen gjithashtu teknikat analitike shkencore. Terminologjia kryesore nënvizon procedurat që duhet të ndiqen për të arritur të dhëna të sakta për procedurat që duhet të ndiqen për restaurimin e objekteve të TK.

Në këto teknika përshkruhen shkurtimisht principet kimike dhe fizike që nevojiten për asimilimin e koncepteve eksperimentale. Çdo leksion përshkruan operimin e instrumentave, disa të dhëna praktike shtesë, si dhe një orjentim shtesë për studime të mëtejshme.

TEMAT:

LEKSIONI 1. Përkufizimi dhe koncepti i restaurimit të veprave të artit.

LEKSIONI 2. Historia dhe Evoluimi i koncepteve të restaurimit të artefakteve.

LEKSIONI 3. Teorinë e restaurimit të veprave të artit dhe objekteve të TK.

LEKSIONI 4. Materia e veprës së artit si dhe uniteti i saj potencial.

LEKSIONI 5. Restaurimi sipas këndvështrimit historik dhe atij estetik.

LEKSIONI 6. Karta të restaurimit si dokumente themelore të parimeve të konservimit të objekteve të TK / karta shqiptare e restaurimit.

LEKSIONI 7. Karta të restaurimit, Karta e Venecias dhe diferencat e perceptimeve të saj në Evropë dhe kontinente të tjera.

LEKSIONI 8. Historia dhe teoria e konservimit arkitektonik, shkollat dhe rrymat më të spikatura në Evropë.

LEKSIONI 9. Konservimi i veprave të artit në Shqipëri ndër vite. Evoluimi i teknikave dhe koncepteve.

LEKSIONI 10. Konservimi i objekteve të Trashëgimisë Kulturore në vendin tonë, Shembuj.

LEKSIONI 11. Metodat analitike dhe shkencore të studimit, dhe risia që sjellin ato në restaurimin e TK materiale.

LEKSIONI 12. Roli i analizave fizike dhe kimike në verifikimin e provave materiale dhe vendimarrjen për ndjekjen e teknikave të restaurimit të objekteve të TK.

LEKSIONI 13. Klasifikimi i analizave konstruktive dhe destruktive për studimin e materialeve arkeologjike Tipet e Analizave ICP.

LEKSIONI 14. Teknikat e rrezeve X dhe mikroanalizat e fluksit elektronik të aplikuara në etapat e restaurimit.

LEKSIONI 15. Kromatografia, Masspektrometria dhe Spektroskopia ICP-MS të aplikuara për analizimin e shtresave sipërfaqësore të materialeve të destinuara për restaurim.

FORMA E KONTROLLIT DHE VLERËSIMIT

FREKUENTIMI:

70% pranisë në seminare e domosdoshme.

15 % e notës përfundimtare nga prania dhe angazhimi gjatë kursit apo seminareve

KONTROLLI I VAZHDUESHËM:

Testi 1 i pjesshëm në javën e 6-të (10% e notës përfundimtare)

Testi 2 i pjesshëm në javën e 10-të (15% e notës përfundimtare)

25 % e notës përfundimtare.

DETYRA E KURSIT:

Detyrë kursi ose konspekt i një teksti apo autori ose ese nga 3- 5 faqe format A4, Times New Roman, madhësia e shkrimit 12, hapësira mes rreshtave 1.5)

20 % e notës përfundimtare

KONTROLLI PËRFUNDIMTAR:

Një test përfundimtar në javën e 16-të të kursit pas kryerjes së 15 javëve të një semestri

40 % e notës përfundimtare

DETYRIMET E STUDENËVE PËR LËNDËN

Frekuentim i rregullt në leksione.

Frekuentim i detyruar në të paktën 70% të seminareve të lëndës.

Përgatitja e një ese-je nga 3-5 faqe format A4, Times New Roman, madhësia e shkrimit 12, hapësira mes rreshtave 1.5.

Pjesëmarrje në testet e pjesëshme gjatë semestrit.

Testi (provimi) përfundimtar (i fundit të smestrit)

LITERATURA:

1. Cesare Brandi, *Teoria del restauro di Cesare Brandi. Lezioni raccolte da L. Vlad Borrelli, J. Raspi Serra e G. Urbani*, Roma, Edizioni di Storia e Letteratura, 1963 - Torino, Einaudi Editore, 1977
2. Giorgio Bonsanti, *Riparare l'arte*, «OPD Restauro», n. 9, 1997, Firenze (pp. 109-112)
3. Nullo Pirazzoli, *Teorie e storia del restauro*, Ravenna, Edizioni Essegi, 1994
4. Alessandro Conti, *Storia del restauro e della conservazione delle opere d'arte*, Milano, Electa, 2002.
5. Benito Paolo Torsello, *Che cos'è il restauro? -Nove studiosi a confronto*, Venezia, [Marsilio Editori](#), 2005.
6. Cousin, H. and Magyar, B. (1994). Precision and accuracy of laser ablation-ICP-MS analysis of rare earth elements with external calibration. *Mikrochimica Acta* 113 313–323.
7. Cox, M. and Mays, S. (eds.) (2000). *Human Osteology in Archaeology and Forensic Science*. London, Greenwich Medical Media.
8. Craig, H. (1961). Standards for reporting concentrations of deuterium and oxygen-18 in natural waters. *Science* 133 1833–1834.
9. Craig, O., Mulville, J., Parker Pearson, M., et al. (2000). Detecting milk proteins in ancient pots. *Nature* 408 312.
10. Cristoni, S. and Bernardi, L. R. (2003). Development of new methodologies for the mass spectrometry study of bioorganic macromolecules. *Mass Spectrometry Reviews* 22 369–406.
11. Cronyn, J. M. (1990). *The Elements of Archaeological Conservation*. London, Routledge.
12. Cronyn, J. M. (2001). The deterioration of organic materials. In *Handbook of Archaeological Sciences*, eds. Brothwell, D. R. and Pollard, A. M., Chichester, Wiley, pp. 627–636.